

**Analiza Statistikore e Treguesve te
Inspektimit Janar-Prill 2019**

**INSPEKTORATI SHTETEROR I PUNES DHE
SHERBIMEVE SHOQERORE**

Proçesi e inspektimit të punës per muajin Janar- Prill 2019 ka pasur në fokus së punës, së secilit inspektor sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore për:

- ✓ ligjshmëri në zbatimin e kohëzgjatjes së punës,
- ✓ pagesës për punë të kryer konform legjislacionit,
- ✓ sigurimit të çdo punëmarrësi,
- ✓ higjienës dhe mirëqenies në vendin e punës,
- ✓ punësimit të ligjshëm të fëmijëve,
- ✓ si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës,

Inspektimi i punës per periudhën Janar-Prill 2019, ka përfshirë 4678 aktivitete ekonomike, me 113445 vende pune të inspektuara.

Gjatë këtyre muajve janë trajtuar me inspektim-ankese 182 raste.

Orientimi i inspektimeve ka qënë:

- Rritja e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
- Minimizimi i punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës urgjente “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën. Nga 386 punëmarres informal te konstatuar gjatë muajve Janar-Prill 225 prej tyre janë konstatuar në inspektime të programuara, 102 punemarres informal ne inspektimet rastesore dhe 48 ne inspektime per shkak ankese.
- Orientimi i kontroleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë të punëmarrësit
- Monitorimi i vazhdueshëm i punës nga portali ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në respektim të standarteve te reja per ketë tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e këtyre shërbimeve në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të shërbimeve me qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna dhe abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si dhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimit.

Vlen të theksohet se, përsa i takon zbatimit të plotë dhe gjithpërfshirës të legjislacionit të punës ISHPSHSH-ja ka lançuar “Matricën e Dënimeve” si një platformë e aksesueshme në Faqen Zyrtare të institucionit. Kjo platformë do të

na japë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapacitetit profesional të inspektorëve të punës, pasi u jep mundësinë e orientimit të qartë në legjislacionin e punës. Gjithashtu përmes saj, do të mund të sigurojmë një proces inspektimi krejt transparent duke ulur në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës.

Mundësia e vetëkorrigjimit të punëdhënësve, të cilët kanë mundësinë e aksesimit në këtë matricë, rrit ndërgjegjësimin e tyre dhe ky ndërgjegjësim përkthehet drejtpërdrejt në përmirësim të situatës së punësimit për punëmarrësit. Trajtimi i barabartë, sa i takon masës së sanksionit për biznesin, në raport me reflektimin të të njëjtave shkelje të dispozitave ligjore ose e thënë ndryshe, masë e njëjtë sanksioni për të njëjtën shkelje ligjore, në të njëjtat kushte, ndikon edhe në përmirësimin e klimës së një konkurrence të ndershme në tregun e punës.

Në këtë muaj:

Janë inspektuar 4678 **subjekte ekonomike private e shtetërore**.


Janë **113 445 vende pune** të inspektuara.

Janë aplikuar 195 masa urgjente “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe 25 masa urgjente “Pezullim” për shkelje flagrante të sigurisë e shëndetit në punë.

Inspektimet e kryera në këtë periudhë, janë rezultat i:

Inspektime të programuara	4372
Inspektime për shkak aksident në punë	64
Inspektime për shkak ankese	182
Inspektime rastësore	60


Inspektime jashte programi



Deget Rajonale	Inspektime te programuara	Inspektime per aksident ne pune	Inspektime per shkak ankese	Inspektime rastesore	% e inspektimeve jashte plani kundrejt totalit te inspektimeve
Berat	207	2	4	0	2.8%
Diber	139	7	2	0	6.1%
Durres	277	8	15	11	10.9%
Elbasan	351	4	8	2	3.8%
Fier	418	2	2	0	0.9%
Gjirokaster	75	2	0	2	5.1%
Korce	349	3	4	10	4.6%
Kukes	123	4	0	15	13.4%
Lezhe	182	5	4	1	5.2%
Shkoder	349	5	6	0	3.1%
Tirane	1552	21	119	9	8.8%
Vlore	350	1	18	10	7.7%
Total	4372	64	182	60	6.5%

Inspektime jashtë programimi në 6.5 % kundrejt totalit për muajt Janar-Prill 2019.

% e inspektimeve jashte plani kundrejt totalit te inspektimeve



Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë muajve Janar-Prill 2019, nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

1	Subjekte të inspektuara Private + Shteterore	4678
2	Vende pune të inspektuara	113455
	me mesatarisht punm/subjekt	24.3
3	Subjekte private të inspektuara	4644
4	Vende pune të inspektuara në subjektet private	106621
	me mesatarisht punm/subjekt	22.9
5	Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	1200
5.1	Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	511
	(42.5% e punëmarrësve pa kontrata)	
6	Punëmarrës informal të evidentuar	386
6.1	Punëmarrëse informale femra të evidentuar	143
7.	Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	371

7.1 Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	141
8 Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	34
8.1 Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	21
9 Punëmarrës të huaj të evidentuar	239
10 Punëmarrës të huaj, pa leje pune	11
11 Punëmarrës me aftësi të kufizuar	92
11.1 Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	25
12 Subjekte për të cilët është mbajtur masë urgjente (për marrëdhënie pune)	195
13. Subjekte për të cilët është mbajtur masë urgjente (për siguri në punë)	25
14 Subjekte me masën “Paralajmërim”	569
15. Subjekte me masën “Gjobë”	57
16 Vlera totale e sanksioneve	14 144 000 lekë
17 Inspektime të planifikuara	4372
18 Inspektime për shkak Ankese	182
19 Inspektime për shkak Aksidenti	64
20 Punëmarrës të aksidentuar	56
21 Punëmarrëse femra të aksidentuara	11
22 Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	17


Të ndara sipas llojit të aktiviteteve ekonomike të inspektuara rezulton se:

Aktivitetet ekonomike të inspektuara gjatë këtij muaji, janë në 40% aktivitete tregtare, 24% aktivitete prodhuese, 7.8%% inspektime të kryera në ndërtim, 19.% të tjera. Më konkretisht të dhënat janë:

- Bujqësi, pyje, peshkim 106
- Miniera karriera 91
- Ndërmarrje Prodhuese 1135
- Elektricitet, gaz, ujë 55
- Tregti, hotel-bar-restorante 1878
- Ndërtim 365
- Transport, magazinim, telekomunikacion 90

- Financë, shërbime të sigurimeve 65
- Aktivitete të tjera 893

Inspektime në aktivitetet ekonomike të licensuara, sipas llojit të aktivitetit



Gjatë periudhes Janar-Prill ka pasur lirime nga Shërbimi civil për shkak të dorëheqjeve, të daljes në pension, dhe largimeve me mase disiplinore.

Dega Gjirokastrë si rezultat i dorëheqjes janë liruar 2 Inspektorë, dhe 1 në pension.

Dega Durrës për 5 inspektor është marrë masa largim nga shërbimi civil përmes procedurës së masës disiplinore dhe 1 inspektor të liruar me dorëheqje, total kjo degë ka 6 vende vakante inspektor.

Dega Dibër ka 1 inspektor të liruar me dorëheqje dhe aktualisht ka 2 vende vakante.

Dega Korçë është 1 inspektor në pension.

Dega Elbasan ka 1 inspektor të liruar me dorëheqje.

Dega Vlorë ka 1 inspektor të liruar me dorëheqje.

Dega Tiranë si rezultat i dorëheqjes është liruar 1 Inspektor, dhe 1 në pension. Dega Lezhë ka 1 Vend vakant

Në lidhje me numrin e dënimeve administrative si “Pezullim për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës”, “Pezullim për shkelje flagrante të sigurisë dhe shëndetit në punë” dënim kryesor “palajmërim”, dënim kryesor “gjobë”, në inspektimet e realizuara në 12 degët rajonale të ISHPSHSH-së rezulton si më poshtë:

Inspektime Total (Private+Shtetërore)

<i>Deget Rajonale</i>	Gjithsej/Inspektime	Pezullim/Marrëdhënie pune	Pezullim/Siguri në punë	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (.000)
<i>Berat</i>	213	2	0	104	1	780
<i>Dibër</i>	148	10	4	8	3	572
<i>Durrës</i>	311	4	1	45	11	1746
<i>Elbasan</i>	365	15	2	23	9	2940
<i>Fier</i>	422	2	1	16	0	0
<i>Gjirokastrë</i>	79	0	0	0	0	0
<i>Korçë</i>	366	12	4	45	0	0
<i>Kukës</i>	142	24	0	37	1	260
<i>Lezhë</i>	192	7	1	39	3	1092
<i>Shkodër</i>	360	9	0	0	7	2560
<i>Tiranë</i>	1701	76	12	84	18	3894
<i>Vlorë</i>	379	34	0	168	4	300
Total	4678	195	25	569	57	14144

Nga inspektimet tematike në këto dy muaj janë 17 inspektime të realizuara me njoftim paraprak nga të cilat:

7 janë realizuar pas kërkesës së subjektit për autorizim punësimi të punëmarrësve të mitur nga ku rezulton të jenë autorizuar 10 punëmarrës të tillë,

4 është realizuar për aprovim autorizimi për të punuar në orë shtesë nga të cilat 2 janë miratuar dhe 6 për miratim leje pune.


Gjithashtu këto muaj janë realizuar 159 inspektime keshilluese dhe tematike mbi aplikuesit e programit IPARD II 2014-2020. Për aplikuesit pas procedurës së inspektimit u është dorëzuar dhe certifikata që verteton përputhshmërinë e subjektit me standartet e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas parashikimeve në legjislacionin e BE-së dhe atë shqiptar në lidhje me investimin dhe me standartet e sigurisë në punë, bazuar në inspektimin e kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në objekt.

Masat administrative

Nga të dhënat e inspektimeve rezulton se në më të shumtën e rasteve subjektet e inspektuara janë dënuar me masën “paralajmërim” në 67 % të tyre , se sa me masat e tjera ndëshkuese, si “pezullim” apo “gjobë”.

Inspektime Total (Private+Shteterore)

Masat Administrative Janar-Prill 2019



Kështu ndër masat administrative të vendosura subjekteve ekonomike rezulton se në 67 e këtyre masave ndëshkuese janë “Paralajmërim”, “Pezullim për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës janë 26.% dhe për 7 % të subjekteve është marrë masa “Gjobë”.

Sipas degëve rajonale këto tregues rezultojnë:


Masa administrative “Pezullim”

Degët Rajonale	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Pezullim	% e subjekteve me Pezullim
<i>Berat</i>	107	2	1.8%
<i>Dibër</i>	25	14	56%
<i>Durrës</i>	61	5	8.1%
<i>Elbasan</i>	49	17	34.6%
<i>Fier</i>	19	3	15.7%
<i>Gjirokastrë</i>	0	0	0%
<i>Korçë</i>	61	16	26.2%
<i>Kukes</i>	62	24	38.7%
<i>Lezhë</i>	50	8	16%
<i>Shkoder</i>	16	9	56.2%

<i>Tirane</i>	190	88	46.3%
<i>Vlore</i>	206	34	16.5%
<i>Total</i>	846	220	26%

% e subjekteve me Pezullim, kundrejt numrit të masave administrative të mara

% e subjekteve me Pezullim




Masa administrative “Paralajmërim”

<i>Deget Rajonale</i>	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Paralajmerim	% e subjekteve me Paralajmerim
<i>Berat</i>	107	104	97%
<i>Diber</i>	25	8	32%
<i>Durres</i>	61	45	73.7%
<i>Elbasan</i>	49	23	46.9%
<i>Fier</i>	19	16	84%
<i>Gjirokaster</i>	0	0	0%
<i>Korce</i>	61	45	73.7%
<i>Kukës</i>	62	37	59.67%
<i>Lezhe</i>	50	39	78%
<i>Shkoder</i>	16	0	0%
<i>Tirane</i>	190	84	44.2%

<i>Vlore</i>	206	168	81.5%
<i>Total</i>	846	569	67.25%

% e subjekteve me Paralajmërim, kundrejt numrit të masave administrative të mara




Masa administrative “Gjobë”

<i>Deget Rajonale</i>	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Gjoba	% e subjekteve me Gjoba
<i>Berat</i>	107	1	0.9%
<i>Diber</i>	25	3	12%
<i>Durres</i>	61	11	18%
<i>Elbasan</i>	49	9	18.36%
<i>Fier</i>	19	0	0%
<i>Gjirokastr</i>	0	0	0%
<i>Korce</i>	61	0	0%
<i>Kukës</i>	62	1	1.6%
<i>Lezhe</i>	50	3	6%
<i>Shkoder</i>	16	7	43.7%
<i>Tirane</i>	190	18	9.47%
<i>Vlore</i>	206	4	1.9%

<i>Total</i>	846	57	6.7%
--------------	-----	----	------


% e subjekteve me Gjoha, kundrejt numrit të masave administrative të mara për muajt Janar Prill 2019

% e subjekteve me gjoha kundrejt totalit të Dënimeve



% e subjekteve me Gjoha sipas llojit të aktivitetit, kundrejt numrit të masave administrative të marra për muajt Janar- Prill 2019.

% e subjekteve me gjobë kundrejt totalit të dënimeve



Sipas llojit të aktivitetit të inspektuar rezulton se dënimet administrative të aplikuara gjatë inspektimeve janë:

	<i>Subjekte të inspektuara Janar-Prill 2019</i>	<i>Subjekte me Mase "Pezullim"</i>	<i>% e Subjekte me Mase "Pezullim"</i>	<i>Subjekt e me Paralajmërim</i>	<i>% e subjekteve me Paralajmërim</i>	<i>Subjek te me Gjobë</i>	<i>% e Subjekte me Gjobë</i>
<i>Bujqësi, pyje, peshkim</i>	106	2	1.8%	5	71.40%	0	0%
<i>Miniera karriera</i>	91	14	15.3%	38	65.50%	6	10.34%
<i>Ndërmarrje Prodhuese</i>	1135	52	4.5%	166	70.60%	17	7.23%
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	55	2	3.6%	7	70%	1	10%
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	1878	87	4.6%	185	65.37%	11	3.88%
<i>Ndërtim</i>	365	21	5.75%	59	68.60%	6	6.90%
<i>Transport, magazinim, telekomunikacion</i>	90	3	3.33%	12	80%	0	0.00%
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	65	1	1.5%	0	0%	0	0.00%
<i>Aktivitete të tjera</i>	893	38	4.2%	97	64.20%	16	10.59%

TOTAL

4678

220

4.7%


569

71.40%


57

6.73%


Subjekte me Paralajmërim sipas llojit të aktivitetit per muajt Janar-Prill 2019.



Subjekte me masën Pezullim per muajt Janar-Prill janë 220



Subjekte me masën Gjobë



Gjatë periudhës Janar- Prill janë ndjekur 25 procese gjyqesore nga të cilat:

- 10 çështje janë fituar (rrezimi i kerkesë-padisë) Të përfunduara
- 3 çështje janë humbur, (shfuqizim akti) Të përfunduara
- 12 çështje janë në vazhdim, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë .

Nga këto 25 procese janë si më poshte:

- 22 Procese gjyqesore me subjektet (Gjobat)

- 3 Procese gjyqësore Marrëdhënie pune.

Nga Gjyqet me Subjektet (Gjoha) 22 te tilla rezultojnë si më poshtë

- 10 Të fituara
- 3 Të humbura
- 9 Në vazhdim në Shkallë të Parë

3 Gjyqet për Marrëdhëniet e Punës janë në vazhdim në Shkallë të Parë.

Shkeljet ligjore për të cilat janë marrë masat administrative janë

- 29 shkelje të dispozitave të Ligjit 7961 “ Kodi i Punes “ kryesisht për marrëdhënie pune
- 18 shkelje të dispozitave të Ligjit 10237 “ Per sigurinë dhe shëndetin në punë “
- 29 shkelje të dispozitave të Ligjit 7961 “ Kodi i Punës “
- 7 shkelje te dispozitave të Ligjit 9634 “ Për Inspektimin në Punë “
- 4 shkelje te dispozitave te Ligjit 9136 “ Për mbledhjen e detyrueshme të kontributeve shoqërore “
- 2 shkelje te VKM nr. 563 “Për miratimin e Rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Përdorimin e Pajisjeve Mbrojtëse Individuale në Vendin e Punës”.
- 1 shkelje te VKM nr.564 “Për miratimin e Rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës”.
- 1 shkelje te VKM nr.639 “Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”.
- 1 shkelje te VKM nr. 312 “Për miratimin e Rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- 1 shkelje te VKM nr.1012 “Për miratimin e Rregullores “Për sinjalet në kantier dhe vendin e punës”.

Për periudhën Janar-prill 2019 janë ankimuar 15 gjoha në Komisionin Ankimimit të Gjobave nga të cilat :

- Shfuqizuar 1 gjobë
- Lënë në fuqi 14 dënime administrative nga të cilat 2 janë paralajmërime

Gjithashtu, jane arketuar vullnetarisht 7 gjoha të vendosura gjatë ketij 4 mujori . Ka nisur procedura për ekzekutim te detyrueshem per 13 subjekte te sanksionuara.per subjektet e tjera ne pritje te plotesimit te afateve administrative dhe gjyqesore.

Të ardhurat nga gjobat e arkëtuar si 4 mujor janë në vlerën 7.692.500 leke.

Inspektive për aksident në punë

Sa i takon inspektiveve për aksident në punë rezultojnë se në 23% të rasteve të inspektimit për shkak aksidenti është marrë masa administrative “Paralajmërim”, dhe në 35.9%% të rasteve është marrë masa administrative “Gjobë”.

- Nga 56 punëmarrës t’ë aksidentuar për periudhën Janar-Prill 2019, 16 prej tyre kanë rezultuar që nuk kanë lidhje drejtpërdrejtë me punën, por janë klasifikuar si aksidente në punë për shkak të ligjit. Kështu, këtu janë përfshirë aksidentet që kanë ndodhur në rrugë nga puna për në shtëpi, aksidentet që kanë ndodhur gjatë punës për shkak të kushteve të rënda atmosferike, apo për shkak të gjëndjes së rëndë shëndetësore të punëmarrësve, që kanë pësuar infarkt.
Nga 17 aksidente me pasoje vdekje, 6 prej tyre kanë ndodhur për një nga shkaqet e cituara më sipër.
- Nga 56 të aksidentuar në total, 11 prej tyre janë femra, ku në pjesën më të madhe të këtyre rasteve janë klasifikuar si aksidente rrugore, ose për shkak të kushteve atmosferike. Raste të cilat kanë rezultuar pa pasoja fatale për jetën.
- Diferenca ndërmjet numrit të inspektiveve për shkak aksidenti dhe numrit të punëmarrësve të aksidentuar, ka të bëjë me rastet që pasi janë iniciuar si aksident në punë, por gjatë hetimit nuk është provuar që jemi para një rasti aksideneti në punë. Kështu, mund të përmendim një rast të ndodhur në subjektin “Red -1999” ku me bashkëpunimin edhe me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, punëmarrësi u gjend i mbytur në det, dhe nuk u arrit të provohej që ka ndodhur për shkak të punës. Gjithashtu, në Degën Durrës u evidentua një rast në një fasoneri “Albastir” ku disa punëmarrësve shfaqen përkeqësim të gjëndjes shëndetësore, të cilët pasi morën trajtim shëndetësor parësor, i morën raport paaftësie me pak se tre ditë, duke u skualifikuar kështu si të aksidnetuar në punë, në bazë të parashikimeve të bëra nga Ligji Nr.10237, date 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe shëndetin në Punë” (I ndryshuar).

Vlen të theksohen edhe rastet kur për të njëjtën ngjarje, janë hapur dy procedura inspektimi për shkak aksidenti në punë, për rastet kur kemi

pas të bëjmë me punë me nënkontraktor, gjë e cila ndihmon në një hetim gjithëpërfshirës të rastit.

- Është rritur numri i masave urgjente të mara për sigurinë në punë, duke pezulluar punën dhe kjo jo vetëm në rastet e aksidenteve, por edhe gjatë inspektimeve rastësore, apo edhe inspektimeve të programuara, por janë evidentuar situatë kur vazhdimi i punës pa PMI dhe Pajisje Mbrojtëse Kolektive do përbënte rrezik eminent për punëmarrësit.
- Rastet e aksidenteve në punë, tek ato që kanë pas të bëjnë drejtëpërdrejt me punën janë marrë denime me masë administrative kryesore, si menyrë për të pasur reagim nga subjekti në mbajtjen në fokus nga ana e tij të ndërmarrjes së të gjithave masave për parandalimin e aksidenteve në punë.
- Janë riinspektuar një pjesë e konsiderueshme e subjekteve ku kanë ndodhur më parë aksidente në punë, me qëllim ndjekjen e realizimit të detyrave të lena.
- Sipas degëve rajonale kemi që numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës dhe Dibër.

<i>Deget Rajonale</i>	<i>Inspektime per aksident ne pune</i>	<i>Paralajmerim</i>	<i>Gjore</i>	<i>Vlere (.000)</i>	<i>Punm/aksidentuar</i>	<i>Punm/Aksident me vdekje</i>
<i>Berat</i>	2	0	1	780	1	1
<i>Diber</i>	7	4	1	260	8	2
<i>Durres</i>	8	4	4	672	6	2
<i>Elbasan</i>	4	1	3	980	3	2
<i>Fier</i>	2	0	0	0	2	1
<i>Gjirokaster</i>	2	0	0	0	1	1
<i>Korce</i>	3	1	0	0	3	1
<i>Kukes</i>	4	2	1	260	3	1
<i>Lezhe</i>	5	2	1	520	5	1
<i>Shkoder</i>	5	0	3	1050	4	3
<i>Tirane</i>	21	1	8	1640	19	2
<i>Vlore</i>	1	0	1	50	1	0
<i>Total</i>	64	15	23	6212	56	17

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik rastet e aksidenteve në punë rezultojnë:

<i>Janar-Prill 2019</i>	Subjekte të inspektuara per shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të Pnm të aksidentuar	Punëmarrës të Pnm te aksidentuar, me vdekje
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	0	0	0
<i>Miniera, karriera</i>	9	11	3
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	15	10	2
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	5	3	2
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	2	2	1
<i>Ndërtim</i>	12	9	5
<i>Transport, telekomunikacion</i>	0	0	0
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	0	0	0
<i>Aktivitete të tjera</i>	21	21	4
<i>Total</i>	64	56	17

Inspektime për shkak ankese

Sa i takon inspektimeve për shkak ankese rezultojnë se në 9% të rasteve është marrë dënim kryesor “Gjobë”, ndërkohë në 30% të këtyre inspektimeve është marrë dënim kryesor “paralajmërim”.

Inspektime për ankese Janar-Prill 2019						
Deget Rajonale	Inspektime për shkak ankese	Pezullim/shkelje flagrante të marrëdhënie të punës	Pezullim/ shkelje flagrante të sigurisë në punë	Masë administrative Paralajmërim	Masë administrative Gjobe	Vlere (.000)
Berat	4	1	0	4	0	0
Diber	2	0	0	0	0	0
Durres	15	0	0	8	3	880
Elbasan	8	1	0	1	1	260
Fier	2	0	0	0	0	0
Gjirokaster	0	0	0	0	0	0
Korce	4	0	0	0	0	0
Kukes	0	0	0	0	0	0
Lezhe	4	0	0	1	1	312
Shkoder	6	1	0	0	3	1030
Tirane	119	11	2	24	9	1994
Vlore	18	3	0	11	3	250
Total	182	17	2	49	20	4726

Numri më i madh i ankesave të trajtuara në këtë muaj është realizuar nga Dega Rajonale Tiranë me 119 inspektime për shkak ankese. Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, inspektimet e kryera për rast ankese janë:

<i>Lloji i aktivitetit</i>	Subjekte të inspektuara për shkak ankese
Bujqësi, pyje ,peshkim	1
Miniera, karriera	2
Ndërmarrje prodhuese	42
Elektricitet, gaz, ujë	2
Tregti, hotel-bar-restorante	42
Ndërtim	7
Transport, telekomunikacion	5
Finance, shërbime të sigurimeve	2
Aktivitete të tjera	79
Total	182

Punëmarrësit.

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezultojnë se:

52.8% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

29.70% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

2.10 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.08% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.02 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

0.32 % e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.04 % e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Sipas degëve rajonale, kategoritë e të punësuarve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:

Aktivitete private + shtetërore të inspektuara gjatë muajve Janar-Prill 2019

Deget Rajonale	Punemarres	Femra	P/Pkontrata	P/page minimale	Te huaj	Me aftesi te kufizuar	Nen 18 Vjeç	Informal	U siguruan	P/aksidentuar	vdekje
Berat	4143	2205	88	2552	42	0	0	4	4	1	1

Diber	4536	670	11	335	79	45	0	9	9	8	2
Durres	13210	8420	21	1500	5	0	10	7	7	6	2
Elbasan	4093	1632	43	2072	5	10	1	18	17	3	2
Fier	9880	4027	4	4220	9	7	0	4	4	2	1
Gjirokaster	799	496	88	383	0	3	5	0	0	1	1
Korce	4196	2606	61	2337	3	0	0	45	45	3	1
Kukes	1288	381	168	492	0	0	0	34	32	3	1
Lezhe	4853	2575	113	2864	31	14	7	17	17	5	1
Shkoder	6863	4328	68	4014	2	0	3	19	10	4	3
Tirane	51655	28973	151	10415	46	13	1	162	161	19	2
Vlore	7939	3607	384	2578	17	0	7	67	65	1	0
Total	113455	59920	1200	33762	239	92	34	386	371	56	17
% kundrejt totalit		52.80%	1%	29.70%	2.10%	0.08%	0.02%	0.30%	0.32%	0.04%	0.01%

Kontrata individuale të punës:

Janë 1012 punëmarrës të evidentuar të aktivitetet private të inspektuara ose 1 % e totalit të punëmarrësve që janë konstatuar gjatë inspektimeve në muajt Janar-Prill 2019, janë evidentuar në punë pa kontrata pune individuale.

Më konkretisht numri i punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune individuale në 12 prefekturat e Vendit në subjekte private është,


Degët Rajonale

Aktivite private të inspektuara Janar-Prill 2019

		Subjekte	Punemarres	Punm pa kontrata	% e Punmarresve pa kontrata
1	Berat	211	3538	88	2.4%
2	Diber	142	3826	11	0.2%
3	Durres	309	12066	21	0.1%
4	Elbasan	361	4055	43	1%
5	Fier	421	8135	4	0.04%
6	Gjirokaster	77	740	88	11.8%
7	Korce	366	4196	61	1.4%
8	Kukes	139	856	34	0.4%

9	Lezhe	189	4099	113	2.7%
10	Shkoder	359	6829	34	0.2%
11	Tirane	1698	51503	151	0.2%
12	Vlore	372	6485	364	5.6%
SHUME		4644	106328	1012	1%

Punëmarrës pa kontrata pune individuale kundrejt totalit të punëmarrësve të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara




Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar pa kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezulton se:

	Lloji i aktivitetit	Subjekte private	Punemarres ne subjektet private	Nr. punm. Pa kontrata individuale	% e punm. Pa kontrata individuale
1	Bujqësi, pyje, peshkim	106	703	0	0%
2	Miniera, karriera	90	3926	16	0.4%
3	Ndërmarrje prodhuese	113	48502	275	0.5%
4	Elektricitet, gaz, ujë	44	800	3	0.3%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	1878	15276	400	26.2%
6	Ndërtim	364	6947	128	1.8%
7	Transport, telekomunikacion	90	1666	35	2.1%
8	Finance, shërbime të sigurimeve	65	1416	7	0.4%
9	Aktivitete të tjera	874	27092	148	0.5%
TOTAL		4644	106328	1012	0.9%

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i punëmarrësve pa kontrata pune individuale evidentohet llojin e aktivitetit Tregti Hotel Bar Restorante ku zë 26.2% të totalit të punëmarrësve evidentuar në punë, pa kontrata individuale.

Punëmarrësit evidentuar në punë pa kontrata individuale, sipas llojit të aktivitetit



Punësimi informal (subjekte private të inspektuara):

Një ndër indikatorët e matshëm në fushën e inspektimit ngelet informaliteti. Ashtu siç detyra dhe misioni i çdo inspektori ngelet udhëheqja nga kërkesat e përcaktuara në politikën e zbatimit të inspektimit, për të gjitha rregullat dhe objektivat në mënyrë të njëtrajtshme, të barabartë dhe transparente ndaj të drejtave të punëmarrësve që respekton ligji. Duke krijuar një praktikë të mirë inspektimi që do të thotë krijimi i një mjedisi pune të mirë, produktive, të sigurt në respekt të normave të së drejtës që të jep ligji. Do të analizojmë indikatorët e matshëm të punëmarrësve informal në inspektimet e programuara dhe në inspektimet e kryera jashtë programit.

Gjatë muajve Janar-Prill 2019, janë evidentuar 386 punëmarrës informal ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 371 prej tyre, nëpërmjet masës urgjente “pezullim” deri në sigurimin e tyre.

Vlen të theksohet se, 58 % e punëmarrësve informal të konstatuar janë evidentuar në inspektime të programuara, 26% në inspektime rastësore dhe 12 % në inspektime për shkak ankese.

Nr.	Indikatorë Inforamiliteti	Muaji
		Janar-Prill 2019
A	Numri i punëmarrësve gjithsej të pasiguarur të konstatuar gjatë procesit të inspektimit	386
A1.1	Numri i punëmarrësve gjithsej të futur në Skemën e Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore gjatë procesit të inspektimit	371
A2.1	Numri i punëmarrësve informal për të cilët nuk është marrë masë urgjente dhe janë raportuar në Drejtorinë e Tatimeve	13
A3.1	Numri i punëmarrësve informal në inspektime të programuar	234
B	Punësimi informal në inspektime jashtë programit	152
B2.1	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime të kryera për shkak aksidenti	2
B2.2	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime të kryera për shkak ankese	48
B2.3	Numri i punëmarrësve informal të konstatuar në inspektime rastësore	102

	<i>Degët rajonale</i>	Aktivitete private të inspektuara			
		Subjekte	Punëmarrës	Informal	U siguruan
1	Berat	211	3538	4	4
2	Diber	142	3826	9	9
3	Durrës	309	12066	7	7
4	Elbasan	361	4055	18	17
5	Fier	421	8135	4	4
6	Gjirokaster	77	740	0	0
7	Korçë	366	4196	45	45
8	Kukës	139	856	34	32
9	Lezhë	189	4099	17	17
10	Shkodër	359	6829	19	10
11	Tiranë	1698	51503	162	161
12	Vlorë	372	6485	67	65
	SHUME	4644	106328	386	371

Aktivitetet ekonomike ku janë evidentuar punëmarrësit informal:

Punëmarrësit informal, sipas llojit të aktivitetit

	<i>Lloji i aktivitetit</i>	Subjekte Private	Punëmarrës në subjektet private	Informal	% Informal, kundrejt punëmarrësve
1	Bujqësi, pyje, peshkim	106	703	4	0.56%
2	Miniera, karriera	90	3926	2	0.05%
3	Ndërmarrje prodhuese	1133	48502	113	0.23%
4	Elektricitet, gaz, ujë	44	800	2	0.25%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	1878	15276	133	0.87%
6	Ndërtim	364	6947	41	0.59%
7	Transport, telekomunikacion	90	1666	11	0.66%
8	Finance, shërbime të sigurimeve	65	1416	1	0.07%
9	Aktivitete të tjera	874	27092	79	0.29%
	TOTAL	4644	106328	386	0.36%

Paga

Punësimi me page minimale rezulton evident në 31.57 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë ketyre dy muaji.

<i>Lloji i aktivitetit (Subjekte Private)</i>	Subjekte private	Punëmarrës në subjektet private	Punm. të siguruar mbi pagë minimale	% kundrejt totalit të punm.
Bujqësi, pyje, peshkim	106	703	438	62%
Miniera, karriera	90	3926	330	8.4%
Ndërmarrje prodhuese	1133	48502	17202	35%
Elektricitet, gaz, ujë	44	800	72	9%
Tregti, hotel-bar-restorante	1878	15276	6839	45%
Ndërtim	364	6947	2550	37%
Transport, telekomunikacion	90	1666	1029	62%
Finance, shërbime të sigurimeve	65	1416	246	17%
Aktivitete të tjera	874	27092	4924	18%
Total	4644	106328	33630	31.6%

Inspektimi në subjekte Fason

Gjatë Muajve Janar Prill 2019 në fokus të inspektimeve kanë qënë dhe subjektet Fason ku janë realizuar 231 Inspektime ose 5 % e inspektimeve në subjekte private, me një numër 24876 punëmarrësish.

Numri i punëmarrësve që punojnë pakontratë individuale pune në këto lloj aktiviteti është shumë i ulët. Janë vetëm 159 punëmarrës që gjatë inspektimeve

rezultuar të punojnë pa kontratë pune individuale nga 24876 punëmarrës në total.

Numri i punëmarrësve evidentuar të punonin informal është 50 për të cilët nëpërmjet marrjes së masës urgjente “Pezullim” të punës së tyre në 50 subjekte, deri në formalizimin dhe deklarimit pranë Tatim-Taksave, tashmë ato rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Rreth 38.5% e punëmarrësve të evidentuar në punë në fasoneri rezultojnë që kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritet mbi pagë minimale dhe 0.21 % rezultojnë që të punojnë në turn të dytë.

Nr	Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm, në turn të II-të (19 ⁰⁰ -22 ⁰⁰)	Nr i Punëm nen 18 vjeç	Nr i Punëm, pa kontrate individuale	Nr. Punëm, të pa siguruar	Nr. Punëm, që u futen në skemën e Sig	Nr punm, të siguruar me page min.
1	Berat	12	2288	3	0	0	0	0	1696
2	Diber	3	243	4	0	1	1	1	45
3	Durres	30	2395	0	4	0	0	0	0
4	Elbasan	8	343	0	0	0	0	0	269
5	Fier	20	2951	0	0	0	0	0	1948
6	Gjirokaster	5	193	0	0	10	0	0	134
7	Korce	25	1076	0	0	24	24	24	477
8	Kukes	1	103	0	0	0	0	0	101
9	Lezhe	15	2371	40	12	92	14	14	1265
10	Shkoder	18	1878	0	7	1	1	1	1094
11	Tirane	70	8683	0	0	2	5	5	1592
12	Vlore	24	2352	5	27	29	5	5	980
	Total	231	24876	52	50	159	50	50	9601

Nga 231 subjekte Fason të inspektuara gjatë kësaj periudhe 47 kanë shkuar me masën administritive paralajmërim, dhe 6 subkete me sanksion në vlerën 1 720 000 lekë.

Dega	Subjekte	Mase urgjente per marredhenie pune	Mase urgjente per sigurine ne pune	Paralajmerim	Saksion	Vlere e gjobes (.000)
------	----------	------------------------------------	------------------------------------	--------------	---------	-----------------------

Berat	12	0	1	5	0	0
Diber	3	1	0	0	0	0
Durres	30	0	0	3	1	100
Elbasan	8	0	0	0	0	0
Fier	20	0	0	2	0	0
Gjirokaster	5	0	0	0	0	0
Korce	25	3	0	4	0	0
Kukes	1	0	0	1	0	0
Lezhe	15	3	0	5	1	520
Shkoder	18	0	0	0	1	480
Tirane	70	5	1	6	2	520
Vlore	24	3	0	21	1	100
Total	231	15	2	47	6	1720

Fenomen evident në këto lloj aktiviteteve është numri i punëmrësve-kursantë. Kështu nga të dhënat e inspektimeve rezultojnë gjithsej 2570 kursantë nga të cilët 143 janë kursantë të marrë përmes Zyrave të Punësimit dhe 2427 rezultuan kursantë të kontaktuar drejtpërdrejtë nga vetë subjektet.

Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm Kursante, mare përmes zyres se punës	Nr i Punëm Kursante kontaktuar drejtpërdrejtë nga subjekti
Berat	12	2288	20	0
Diber	3	243	25	0
Durres	30	2395	0	0
Elbasan	8	343	0	0
Fier	20	2951	21	0
Gjirokaster	5	193	25	0
Korce	25	1076	0	0
Kukes	1	103	0	0
Lezhe	15	2371	0	2371
Shkoder	18	1878	0	0
Tirane	70	8683	3	1
Vlore	24	2352	49	55
Total	231	24876	143	2427

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Në përputhje me objektivat e saj për vitin 2019, dhe në zbatim të planit të inspektimit për muajin Prill 2019, DISSHSH, edhe për këtë muaj planifikoi takime me strukturat e shërbimeve shoqërore të Bashkive, e konkretisht, në Bashkinë Korçë, dhe inspektime të qendrave të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Tiranë. Treguesit numerik të aktiviteteve inspektuese, për muajin Prill 2019, dhe progresiv si katërmujor, janë:

Muaji Prill 2019

- ✓ **Planifikuar 1 dhe realizuar 1** takim dhe vlerësim të situatës së përgjithshme në Bashkinë Korçë.
- ✓ **Planifikuar** inspektime në **17** qendra përkujdesi shoqëror dhe **realizuar** inspektime në **17** qendra te përkujdesit shoqëror, 6 në Tiranë dhe 11 në Korçë, nga të cilat 3 qendra të reja u inspektuan për herë të parë.

Progresiv, periudha Janar – Prill 2019

- ✓ **Planifikuar 4** Bashki, për takime dhe vlerësime të situatës së përgjithshme.
Realizuar takime në **4** Bashki, dhe vlerësuar situata e përgjithshme e shërbimit në **7 njësi shërbimi**.
- ✓ **Planifikuar** inspektime në **48** qendra te përkujdesit shoqëror.
Realizuar inspektime ne **51** qendra të përkujdesit shoqëror. Inspektimi i 3 qendrave të inspektuara mbi planifikim, i perkasin inspektimit për procedurë liçensimi, (2 qendra), dhe trajtim ankese, (1 qendër).
- ✓ **Gjithësej**, janë inspektuar e vlerësuar **58 qendra/njësi** që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror.

Inspektimi Standarteve të shërbimeve shoqërore

Nga inspektimi i qendrave multidisiplinare të Bashkisë Tiranë u konstatua, dhe nënvizohet se, nga ana e këtyre qendrave, janë marrë masa dhe janë realizuar rekomandimet e dhëna në inspektimet e mëparshme nga Inspektoriati. Grupi i inspektimit, konstatoi që ,përgjithësisht, qendrat sociale të Bashkisë Tiranë, ofrojnë shërbime sociale me standarte. Ato vlerësohen, si në drejtim të investimeve të bëra për përmirësimin e kushteve të ambjenteve, ku veçojmë standartet e larta të Qendrës Sociale “Gonxhe Bojaxhiu”, po ashtu, edhe në drejtim të kapaciteteve të stafit, (plotësimi me figurat e duhura të ekipit multidisiplinar). Gjithashtu, vlerësohet shperndarja territoriale pranë komuniteteve në nevojë e qendrave multidisiplinare, ofrimi i kujdesit për disa target – grupe në nevojë. Vlerësohet funksionimi i tyre si pjesë e një rrjeti, e bashkëpunimi me strukturat e tjera të shërbimeve publike, si të arsimit, të shëndetësisë, etj.

Një model i ri shërbimi të përkujdesit shoqëror, i cili vlerësohet si model që duhet të aplikohet edhe nga Bashki të tjera, u konstatua Qendra Sociale

“Streha Tirana”. Qendra synon t’ju vijë në ndihmë individëve të ç’integruar, me një stil jetesë të veçantë, apo sikurse quhen në gjuhën e përditëshme “endacakë”. Qendra, me kapacitet akomodimi për 30 individë në natë, ka krijuar kushte të mira shërbimi e përkujdesi. Qendra funksionon nga ora 18.00 e mbrëmjes deri në orën 08.00 të mëngjesit. Në të shërben një staf prej 12 punonjësish. Qendra vlerësohet edhe për paketën e përkujdesit, e cila nuk kufizohet vetëm me mundësimin e një shtrati për kalimin e natës, por ajo ofron edhe dy vakte ushqimi, (darkë dhe mëngjes), kushte dhe mundësi për higjenë personale, mundësi kujdesi shëndetësor, duke pasur në stafin e shërbimit edhe infermier, si edhe mbështetje psiko-sociale, këshillim e nxitje për integrim dhe për forcimin e lidhjeve me familjet, apo mbështetje ekonomike për familjet.

Përsa i takon qendrave të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Bashkinë Korçë, u konstatuan zhvillime pozitive si në qendrat publike të përkujdesit shoqëror, po ashtu edhe në qendrat e përkujdesit të organizatave jofitimprurëse. Përtej konstatimeve dhe rekomandimeve, rutinë, të dhëna për secilën qendër, për Bashkinë Korçë, gjykohet se është e nevojshme më shumë vëmendje nga ana e saj si për shërbimet aktuale, për të cilat, në rradhë të parë, ka nevojë të rishikohen organikat dhe të plotësohen stafet me figura profesionistësh, por edhe për angazhim në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që ka për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sikurse kërkohet nga Ligji Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë vlerësohet e nevojshme, organizimi i takimeve me nivelet politike drejtuese vendimmarrëse të kësaj bashkie, në muajt e ardhshëm.

Në përfundim u përgatit relacionin përkatës për MSHMSH, SHSSH dhe Bashkitë përkatëse, në të cilat u prezantuan konstatimet dhe rekomandimet e DISSHSH me qëllim, përmirësimin e cilësisë së shërbimit, si edhe përafrimin e shërbimit me standartet e reja të sapomiratuara për shërbimet e përkujdesit komunitar shumëdisiplinor, Udhëzimi Nr.911, datë 27.12.2018.